

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË “Gribli-Alb” SHPK

THEMELIMI

NENI 1 - ORTAKËT THEMELUES

- 1.1 Shoqëria “**Gribli-Alb**” SHPK themelohet nga Ortaku i vetëm:

Z. Ivan Motta shtetasi italian, lindur më 09.06.1972 ne Melfi (PZ), Itali, rezident ne Montalto Dora (TO), Itali, mbajtes i Passaportes Nr. YB1287224 me zotesi te plote per te vepruar;

I cili me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë krijon shoqërinë si vijon.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

NENI 2 - EMËRTIMI

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është “**Gribli-Alb**” Sh.P.K (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

NENI 3 - FORMA LIGJORE

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 4 - BAZA LIGJORE

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

NENI 5 - PERSONALITETI JURIDIK. KOHËZGJATJA

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

NENI 6 - SELIA

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. Besim Alla, Pall. Alfa, Hyrja 4, Dyqani nr.14, Yzberisht, Tirane, Shqiperi.
- 6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera Shqiptare ose te huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

NENI 7 - EMBLEMA. VULA

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

NENI 8 - OBJEKTI

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:
-Konsulencës në fushën e informatikes, zhvillim dhe tregtim i software per te trete sipas kontratave te porosise;
-Formim Profesional;
-Shitja e të mirave dhe shërbimeve me pakicë ose me shumicë, qoftë edhe në formën e tregtisë elektronike;
- 8.2 Shoqëria mundet gjithashtu të marrë, kuota pjesmarrese dhe aksionere ne shoqeri te tjera qe kane qellime plotesuese qe lidhen qellimisht apo jane analoge me te. Te ndermarre cdo aktivitet liggjor te lejuar nga legjislacioni Shqiptar;
- 8.3 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetem.

NENI 9 – KAPITALI THEMELTAR

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 (njqind mije leke).
- 9.2 Kapitali themeltar përbehet nga 1 (një) pjese.
- 9.3 Kapitali themeltar zotërohet nga Ortaku i Vetëm në masën 100% të kapitalit të shoqërisë.
- 9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

NENI 10 - TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET

- 10.1 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek te trete ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr 9901, date 14.4.2008 “Per Tregjetaret dhe Shoqerite Tregjetare” me amendamentin perkatese.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakut të Vetëm.

NENI 11 – ZMADHIMI I KAPITALIT SHOQEROR

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogelohet me vendim të Ortakut të Vetem.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nepermjet nenshkrimit dhe shlyerjes se pjeseve te tjera te kapitalit nga ortake te rinj. Ortaket e rinj pranohen dhe miratohen si te tille me vendim te Ortakut te Vetem.

NENI 12 – ZVOGELIMI I KAPITALIT SHOQEROR

- 12.1 Zvogelimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

- 12.2 Propozimi i zvogelimit do të paraqitet ekspertit kontabel të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Ortaku i vetëm i shoqërisë. Eksperti kontabel dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do të paraqesin Ortakut të Vetëm raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogelimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogelimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakut të vetëm i saj.

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 13 - VENDIMET E ORTAKUT TË VETËM

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm i saj.
- 13.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht:
- Ndryshimin e selisë dhe të emërimit të shoqërisë;
 - Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
 - Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
 - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
 - Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
 - Miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë
 - Transformimin e shoqërisë në formë të tjera;

NENI 14 - ADMINISTRIMI

- 14.1 Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga një ose më shumë administratorë që emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe të drejtojë punën e përditshme të shoqërisë.
- 14.2.1 Administratori i shoqërisë është:
- Z. Ivan Motta** shtetasi italian, lindur më 09.06.1972 në Melfi (PZ), Itali, rezident në Montalto Dora (TO), Itali, mbajtës i Passaportes Nr. YB1287224;
- 14.3 Administratori është përgjegjës për veprimtarinë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose mëpërfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - Përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;
 - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloji natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektivave të saj.
 - Administratori ka të drejtë për të përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri të palëve të treta, institucione apo entitete publike ose private,
 - lidhë kontrata për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta;
 - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;

- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryej çdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- Te vendose për hapjen e degeve, zyra të përfaqësimit si dhe të nënshkruajë kontratat e qerave në emër dhe për llogari të shoqërisë;
- Te ndryshojë seline, të hapë zyra dytesore si dhe nënshkruajë kontrata qeraje për këto zyra;
- Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për administrimin efikas të Shoqërisë në Shqipëri.

14.4 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Ortakut të Vetëm.

NENI 15– VITI FINANCIAR

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Përgjatë vitit, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

NENI 16– BILANCI. KONTABILITETI.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit deri në fund të muajit Mars të çdo viti pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislativës përkatëse. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

NENI 17– TË ARDHURAT, DIVIDENDI

- 17.1 Shoqëria mund të krijojë fonde rezerve për realizimin e qëllimeve të aktivitetit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 17.2 Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen nga Ortaku i Vetëm.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 16 – LIKUIDIMI

16.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Ortakut të Vetem.

16.2 Me vendimin e Ortakut të Vetem caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.

16.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjendjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për perfundimin e tij. Në perfundim të kësaj procedure, Ortaku i Vetem do të shqyrtojë bilancin perfundimtar dhe do të miratojë perfundimin e procedurave të likuidimit.

NENI 19– MOSMARRËVESHJET

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tirane, date 04.09.2018

ORTAKU I VETËM

Z. Ivan Motta

Perfaqësuar me prokurë dt. 03.09.2018

Nr. 1128 Rep dhe nr. 452 Kol

Nga **Znj. Enika Hajdari**

